


Plani i përbashkët ndërinstitucional për parandalimin e krimit në bashkinë Elbasan

Pas dakordësimit me drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit” (Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Drejtorisë Vendore të policisë Elbasan dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan) në datë 8 Tetor 2021 u realizua takim publik i “trekëndëshit” me grupet e interesit. Ky takim konsultues me qytetarët, i shërbeu identifikimit të problemeve të ndryshme që shqetësojnë komunitetin vendor lidhur me rendin dhe sigurinë publike.

Cikli i qasjes gjithëpërfshirëse për parandalimin e krimit (bashki- polici-prokurori)



Takime informale konsultuese midis drejtuesve të “trekëndëshit” sipas kërkesës së njërit prej tyre

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të identifikuar sipas fushave të përgjegjësive së institucioneve të “trekëndëshit” dhe aktoreve të tjerë publik dhe jo publik. Ai është një mjet plotësues për përmirësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe adresimin e problematikave të identifikuar gjatë takimeve konsultuese. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave të paraqitura si më poshtë:

Objektivi 1. Ngritja e kapaciteteve dhe investimi multi aktorial i cili përfshin qytetarët për parandalimin e krimit në bashkinë Elbasan;

Objektivi 2. Reduktimi i intensitetit dhe eliminimi gradual i dukurive që kërcënojnë sigurinë publike dhe veçmas grupet vulnerabël;

Objektivi 3. Investimi i një qasjeje të vazhdueshme, të përsëritur çdo 6-muaj dhe gjithëpërfshirëse të “trekëndëshit” me publikun;

Çështjet e diskutuara në këtë takim njëherazi dhe çështjet e rendit dhe sigurisë publike të evidentuara në vite nga aktorë të ndryshëm publik dhe qytetar në bashkinë e Elbasanit, u morën në konsideratë për përgatitjen e këtij plani. IDM në konsultim të vazhdueshëm me ekspert të bashkisë, policisë, prokurorisë, drejtorisë arsimore por edhe të aktorëve të tjerë të shoqërisë civile punuan për hartimin e një plani shumë aktorial për rendin dhe sigurinë publike.

Ky plan do të diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e rradhës të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike, ndërkohë që është rënë dakord që gjashtë muaj pas miratimit të këtij plani, drejtuesit e institucioneve të “trekëndëshit” në komunikim me qytetarët do të bëjnë një vlerësim të ecurisë së zbatimit të planit dhe të objektivave në vazhdimësi. Kjo përvojë siç është përmendur më sipër përsëritet çdo gjashtë muaj.

Prioritizimi i masave në të “lartë”, “moderuar”, “ulet”, nuk nënkupton qëndrim të diferencuar por tërheq vëmendjen dhe përqendrimin e përpjekjeve në çështjet që kanë risk më të lartë për momentin. Në vazhdimësi, në varësi të arritjeve mbi bazën e punës së kryer dhe vlerësimit të aktorëve, intensiteti i masës ndryshon çdo gjashtë muaj.

Tabela nr.1 Plani i përbashkët ndërinstitucional për parandalimin e krimit në bashkinë Elbasan

Problematikat e identifikuar mëposhtë, të cilat janë shënuar me ngjyrë gri, janë përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022.

Nr.	Problematika e identifikuar	Prioriteti • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për adresimin e problematikës	Institucioni përgjegjës për realizimin e aktivitetit
1.1	Përgatitja dhe ngritja e kapaciteteve të “trekëndëshit” në kuadër të këtij plani	Prioritet i moderuar	1. Bashkia miraton buxhetin në zbatimin e neneve 68,69 për ligjin e qeverisjes vendore për ngritjen e strukturave komunitare në qytetin e Elbasanit (parashikohen rreth 24 struktura komunitare/ ndërlidhës për gjithë territorin e qytetit të Elbasanit) 2. Drejtuesit e institucioneve të bashkisë, policisë dhe prokurorisë marrin masa paraprake për realizimin e aktiviteteve të këtij plani 3. Ngritja e strukturës teknike në përbërjen e së cilës janë përfaqësues të policisë, prokurorisë dhe bashkisë. Kjo strukturë funksionon si	Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Bashkia Elbasan Këshilli Bashkiak OJF dhe IDM

			<p>sekretariat teknik i “trekëndëshit” pranë bashkisë</p> <p>4. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të strukturave komunitare për partneritete me institucionet</p>	
1.2	Përballja me dukurinë e “kulturës së heshtjes” nga institucionet e “trekëndëshit”	Prioritet i moderuar	<p>1. Rritja e komunikimit dhe transparencës të çdo institucioni në mënyrë periodike me qytetarët (sipas specifikave të cilit prej institucioneve)</p> <p>2. Mbajtja e takimeve periodike me OJF dhe grupe të tjera të interesit nga institucionet e “trekëndëshit”</p> <p>3. Rritja e komunikimit dhe partneritetit të policisë me qytetarët (përmes strukturave komunitare)</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p>
1.3	Siguria në shkollë	Prioritet i moderuar	<p>1. Vlerësimi i efektivitetit të sistemit aktual të kamerave të sigurisë</p> <p>2. Vlerësimi i mundësisë për bashkë menaxhim të sistemit</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p>

			<p>të kamerave mes bashkisë dhe policinë</p> <p>3. Krijimi i një sistemi të integruar të monitorimit të kamerave për qytetin e Elbasanit</p> <p>4. Ofrimi i trajnimeve tek mësuesit dhe nxënësit për t'u përgatitur për mënyrat e përgjigjes në rast emergjencash</p> <p>5. Vendosja e pajisjeve për t'u përgjigjur në rast zjarri për të gjithë shkollat në bashkinë Elbasan</p>	<p>Drejtoria Arsimore</p> <p>Shoqëria Civile</p>
1.4	<p>Konsumi i lendeve narkotike, alkoolit, dhe duhanit nga të rinjtë</p> <p>(Gjatë vitit 2021, janë konstatuar 63 raste të prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, me 102 autorë të evidentuar si të përfshirë në këto vepra penale nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan)</p>	Prioritet i lartë	<p>1. Zhvillimi i orëve edukative ligjore nga Prokuroria për të rinjtë</p> <p>2. Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis policisë, shkollës, nxënësve dhe prindërve</p> <p>3. Zhvillimi i ditëve të hapura në shkolle</p> <p>4. Matja e natyrës dhe shtrirjes së modeleve dhe</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>Drejtoria Arsimore</p>

	(Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)		<p>tendencave të abuzimit me lëndët narkotike</p> <p>5. Mbledhja e të dhënave për rrezikun dhe faktorët mbrojtës në të gjithë komunitetin</p> <p>6. Analizimi i kulturës së komunitetit dhe se si ajo kulturë ndikon dhe ndikohet nga abuzimi me drogën</p> <p>7. Konsultimi me liderët e komuniteteve, dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë në parandalimin, trajtimin e abuzimit me drogën, shëndetin mendor, dhunën në familje, të rinjtë dhe fusha të ngjashme</p> <p>8. Vlerësimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për problemin</p> <p>9. Identifikimi i përpjekjeve ekzistuese parandaluese që janë duke u zhvilluar për të adresuar problemin</p>	
1.5	Dhuna në familje (Për vitin 2021 janë evidentuar 56 raste të dhunës në familje në këtë	Prioritet i lartë	1. Konsultimi midis bashkisë dhe OJF-ve për të identifikuar problematikat dhe fushat	Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan

	<p>bashki/ 7 vepra penale më pak se në vitin 2020, statistika nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan)</p> <p>(Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)</p>		<p>prioritare për këtë problematik</p> <p>2. Nxitja e partneritetit midis policisë dhe strukturave komunitare/ ndërlidhësit komunitar (Këshilli i fshatit, Kryetari i fshatit)</p> <p>3. Drejtoria vendore e Policisë Elbasan do të ndërmarrë krijimin e nje databaze në Drejtorinë e Policisë me të gjitha rastet dhe individët e dhunuar apo të pajisur me urdhër mbrojtje</p> <p>4. Vendosja e numrave të kontaktit me viktimat e dhunës dhe përfaqësues të Komisarariatit të Policisë</p> <p>5. Marrja e informacionit në mënyre periodike nga personat që kane qenë apo janë objekt i dhunës në familje</p> <p>6. Analizimi në baza periodike të rasteve për dhunën në familje/ bazë gjinore çdo javë apo muaj</p>	<p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>OJF</p>
--	---	--	---	--

			7. Aktivitete sensibilizuese por dhe në ato denoncuese për dhunën në familje	
1.6	Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm	Prioritet i ulët për bashkinë Elbasan	<p>1. Takime sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere të aktoreve të ndryshëm sipas problematikave</p> <p>2. Bashkëpunim midis qendrës së bashkëpunimit Ndërfetar, institucioneve të “trekëndëshit” dhe shoqërisë civile</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>OJF</p>
1.7	<p>Zonat e “nxehta”/hotspotet për përdoruesit dhe shpërndarësit e drogës apo të krimit</p> <p>(Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)</p>	Prioritet i lartë	<p>1. Identifikimi i zonave të nxehta dhe publikimi i tyre</p> <p>2. Përmirësimi i një sistemi vëzhgues të kamerave në qytet në mënyrë të veçantë në zonat e “nxehta”/ hotspotet</p> <p>3. Puna operative në forma të ndryshme e policisë dhe mënyra të ndryshme për të goditur grupet kriminale</p> <p>4. Evidentimi individual i frekuentuesve të këtyre zonave dhe bashkëpunimi ndërinstitucional për të ulur</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>Përfaqësues të komunitetit</p> <p>OJF</p>

			<p>intensitetin e përfshirjes individuale në grupe</p> <p>5. Ndjekja në vazhdimësi të dinamikës së lëvizjes dhe ndryshimit të zonave të “nxehta”</p> <p>Zonat e nxehta të identifikuara</p> <p>- Në lagjen nr. 1</p> <p>Në lagjen "Emin Matraxhiu" Rruga "Borodin Mitarja" pranë piceri Jurevi, parku i lojërave midis 2 pallateve Lagja "Emin Matraxhiu" Rruga "Besim Qorri" prapa stadiumit e prapa pishinës së vjetër</p> <p>Lagja "Emin Matraxhiu" në Krastë pranë pompave të ujit të pijshëm në fund të asfaltit</p> <p>- Në Lagjen nr. 2</p> <p>Nuk ka</p> <p>- Në lagjen nr 3</p> <p>Tek stacioni i trenit</p>	
--	--	--	---	--

			<p>- Në Lagjen nr. 4</p> <p>Lagja "Kala" tek ish shkolla "Ahmet Dakli"</p> <p>Lagja "Partizani" pranë sheshit të Saraçëve</p> <p>- Lagja nr. 5</p> <p>Nuk ka</p> <p>- Lagja nr. 6</p> <p>Rruga "Mustafa Demiri" tek qendra shëndetësore</p> <p>Rruga "Buharedin Mitarja" tek ura (poshtë urës)</p> <p>Tek parku "Rinia" pjesa e betoneve nëntoke</p>	
1.8	Trafikimi i qenieve njerëzore	Prioritet i moderuar	<p>1. Shkëmbim informacioni midis institucioneve për individë potencialisht vulnerabël ndaj trafikimit</p> <p>2. Mbajtja e seancave ndërgjegjësuese nga OJF-të për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore</p> <p>3. Zgjerimi i kapaciteteve për strehimin dhe ofrimin e</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>Drejtoria Arsimore</p> <p>OJF</p>

			mundësive për punësimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore	
1.9	Kultivimi i bimëve narkotike	Prioritet i lartë	<p>1. Hartzimi i zonave me risk të lartë për kultivimin e kanabis dhe një bazë të dhënash të individëve të përfshirë në vite</p> <p>2. Sensibilizimi i komuniteteve në zona me risk të lartë</p> <p>3. Komunikimi publik nga ana e policisë për territoret në të cilat janë kultivuar bimë narkotike</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>Drejtoria Arsimore</p> <p>OJF</p>
1.10	Fëmijët në situatë rruge <i>(Përditësuar nga takimit i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mbajtur më datë 03 Shkurt 2022)</i>	Prioritet i lartë	<p>1. Angazhim maksimal dhe marrje e përgjegjësi për trajtimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge bazuar në parashikimet ligjore deri në procedimin penal të prindërve/kujdestarëve apo personave të tjerë madhorë që detyrojnë fëmijët të lypin duke i ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta</p> <p>2. Forcimi i bashkëpunimit për Menaxhimin e rasteve</p>	<p>Drejtoria e Policisë/ Komisariati i Policisë Elbasan</p> <p>Prokuroria e Rrethit Gjyqësor</p> <p>Bashkia Elbasan</p> <p>Drejtoria Arsimore</p> <p>Drejtoria e Shërbimit Social</p> <p>OJF</p>

			<p>emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë dhe prokurorinë</p> <p>3. Formalizimi i skuadrave të terrenit si një strukturë e tipit task-force me protokoll të qartë pune, përmes një Urdhri të brendshëm për punonjësit e përfshirë (referuar dhe NJVNR-ve)</p> <p>4. Hartimi i një plan veprimi lokal ku të përfshihen të gjitha strukturat, institucionet përgjegjëse, burimet komunitare (biznese, pika kontakti në komunitet) duke përcaktuar angazhimet e tyre në këtë proces</p> <p>5. Takime periodike raportuese dhe llogaridhënie mes përfaqësuesve të mekanizmit të koordinimit në nivel lokal dhe organizatat e përfshira në identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge</p> <p>6. Fushata ndërgjegjësuere për të informuar publikun mbi</p>	
--	--	--	--	--

			<p>fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge</p> <p>Hotspotet e fëmijëve në situatë rruge</p> <p>Nga Drejtoria e shërbimit të kujdesit social dhe komunitar si edhe skuadrat e terrenit janë identifikuar këto pika:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kryqëzimi pranë “Konstantin Kristoforidhit” -Zona nga Stadiumi, Bulevardi kryesor deri në fillim të fushës së Loparit -Zona pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” -Zona pranë kolaudimit të mjeteve -Rruga Ibrahim Dinçi 	
--	--	--	--	--

Shënim: Ky plan parashikohet për një afat 3-vjeçar me rishikime çdo 6 muaj